



**Bashkia Shkodër**

Nr. 133 Prot.

Tiranë, datë 18/12/2023

Nr. 19449 Prot.

Shkodër, datë 18/12/2023

## MEMORANDUM MIRËKUPtimi

*NDËRMJET*

**QENDRËS SË STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE**

**PËR ARBËRESHËT**

*DHE*

**BASHKISË SHKODËR**

Sot, më datë \_\_\_/\_\_\_/2023, në Shkodër lidhet ky memorandum mirëkuptimi ndërmjet:

**QENDRA E STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE PËR ARBËRESHËT(QSPA)**, si person juridik publik buxhetor, me nr NUIS M01317452W, që ushtron veprimtarinë në bazë të Ligjit Nr.16/2018 “Për Diasporën”, indryshuar, VKM nr.601, datë 04.09.2019 “Për krijimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, VKM nr.81, datë 09.02.2022 “Për përcaktimin e fushes së përgjegjësisë Shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”, përfaqësuar nga Drejtori ekzekutiv **Znj. Diana Kastrati**.

**BASHKIA SHKODËR** organ vetëqeverisje vendore, i përfaqësuar sipas parimeve të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore dhe të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, përfaqësuar nga Kryetari **Z. Benet Beci**.

## PREAMBUL

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe Bashkia Shkodër, të cilët në vijim të këtij dokumenti do të quhen, *Palë*:

*Duke marrë në konsideratë* që trashëgimia historike e kulturore e Shqiptarëve të Italisë, të njohur me emrin Arbëreshë, njihet përgjithësisht si trashëgimi kombëtare;

*Duke vlerësuar që* QSPA ka si objektiv themelor vlerësimin, evidentimin dhe përhapjen e gjuhës, historisë, letërsisë e të gjithë trashëgimisë kulturore, si të formës materiale ashtu edhe asaj jomateriale e gojore, dhe gatishmërinë e Bashkisë Shkodër për t'iu bashkëngjitur aktiviteteve mbarë kombëtare lidhur me komunitetet arbëreshe ;

*Për të evidentuar* gatishmërinë e palëve në ndërveprime me projekte, evente e aktivitete të ndryshme, në mënyrë që të kontribuojnë në promovimin e kulturës arbëreshe në brezat e rinj.

*Me synimin* për të nxitur bashkëpunimin midis dy institucioneve për shkëmbimin e ekspertizës dhe përkujtimin e ngjarjeve më të rëndësishme historike të komunitetit arbëresh, nxitjen e leximit dhe të krijimtarisë të lidhur me promovimin e letërsisë arbëreshe dhe të autorëve që studiojnë letërsinë arbëreshe brenda dhe jashtë vendit;

Palët kanë rënë dakord të lidhin këtë Memorandum Mirëkuptimi, në vijim e quajtur *Memorandumi*;

## **Neni 1**

### **Baza ligjore**

Palët do të bashkëpunojnë në zbatim dhe respektim të ligjit nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; Ligjin nr. 16/2018 “Për diasporën” i ndryshuar; VKM-së nr. 601, datë 04.09.2019 “Për krijimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët”,

## **Neni 2**

### **Qëllimi memorandumit**

Qëllimi i këtij Memorandumi mirëkuptimi është bashkëpunimi ndërinstytucional nëpërmjet organizimit të aktiviteteve dhe projekteve të përbashkëta, të cilat do t'i shërbejnë shkëmbimit të eksperiencave të ndërsjella ndërmjet dy institucioneve.

## **Neni 3**

### **Objekti i memorandumit**

Palët bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për:

- a. Promovimin në mënyrë aktive të përhapjes së gjuhës dhe kulturës arbëreshe;
- b. Organizimin e aktiviteteve dhe pjesëmarrjen në konferenca;
- c. Ofrimin e përdorimit të ambienteve të tyre për konferenca dhe aktivitete.

## **Neni 4**

### **Zbatimi i memorandumit**

1 Ky Memorandum mirëkuptimi pasqyron pikëpamjet dhe synimet e Palëve për të bashkëpunuar në baza jo ekskluzive, të shprehura në mirëbesim, por pa krijimin e ndonjë detyrimi ligjor ose kryerjen e ndonjë përgjegjësie nga ana e ndonjëres prej tyre.

2 Ky Memorandum mirëkuptimi nuk do të kufizojë të drejtën, ose nuk do t'i pengojë Palët të hyjnë në memorandume ose angazhime me palët e tjera në lidhje me ndonjë aktivitet, projekt ose fushë bashkëpunimi të mbuluar nga ky Memorandum.

3. Palët do të jenë përgjegjëse për veprimet dhe lëshimet në lidhje me këtë Memorandum mirëkuptimi dhe zbatimin e tij.

4. Bashkia Shkodër, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmiresimit të Klimës së Biznesit organizon, monitoron aktivitetin dhe raporton me ane të një relacioni tek titullari institucionit.

## Neni 5

### Kostot financiare

Ky memorandum mirëkuptimi nuk është burim i krijimit të detyrimeve financiare ndërmjet Palëve. Çdo pale merr përsipër të përmbushë detyrimet sipas këtij memorandum pa pretendim financiar ndaj palës tjetër.

## Neni 6

### Kohëzgjatja dhe ndryshimi

Ky memorandum mirëkuptimi nënshkruhet për një afat kohor të pacaktuar dhe mund të ndryshojë vetëm me dakortësi të palëve nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim.

## Neni 7

### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandum mirëkuptimi zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

## Neni 8

### Hyrja në fuqi

Memorandumi i mirëkuptimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij dhe publikohet në faqet zyrtare të Palëve.

Memorandumi i mirëkuptimit përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen pranë Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe dy pranë Bashkisë Shkodër.

**PËR**

**QENDRËN E STUDIMEVE DHE  
PUBLIKIMEVE PËR ARBËRESHËT**

**DREJTOR EKZEKUTIV**

**Znj. Diana KASTRATI**




**PËR**

**BASHKINË SHKODËR**

**KRYETAR**

**Z. Benet BECI**



**ME VËNDIM DELEGIMI**

**ZV/KRYETAR**

**Z. Rudin BEKA**